



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Pemëtari - Vreshtari

Programi: Pemëtari Vreshtari

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Agon Statovci, me titull:

“Ndikimi i përdorimit të mikorizës te dredhëza – kultivari Albion”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 11 deri me datë 18.07.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. ass. Muhamet Zogaj anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu , përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI

PROGRAMI PEMËTARI -VRESHTARI



Tema:

**“NDIKIMI I PËRDORIMIT TË MIKORIZËS TE DREDHËZA – KULTIVARI
ALBION”**

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Agon Statovci

Prishtinë, 2024

ABSTRAKTI

Dredhëza bënë pjesë në grupin e pemëve të imëta e njohur me vlera të larta ushqyese dhe tregtare. Shquhet për kthimin e shpejtë të investimeve dhe krijimin e të hyrave të larta për njësi të sipërfaqes. Rritja e rendimenti dhe cilësisë së frutave është një interes i veçantë. Kjo mund të arrihet vetëm me përmes zbatimit të teknologjive dhe teknikave të reja të prodhimit. Kërkesat e vazhdueshme të tregut vendor ashtu edhe të atij ndërkombëtar si dhe mundësit e favorshme për kultivim në vendin tone vazhdojnë të nxisin shumë pyetje rreth formës me të përshtatshme të kultivimit si dhe trajtimet që duhet bërë për të pas një rendiment dhe cilësi të frutave më të lartë. Në rastin tonë është hulumtuar kultivari i dredhëzës Albion ku kemi aplikuar trajtimin me mikorizë. Në këtë rast janë përfshirë katër tretmanë: Kontroll, Myco Apply, Nutria Bio, Nutria Bio + Trichowell. Për secilin tretman për hulumtim janë marrë nga 15 bimë të vendosura në tri përsëritje. Në studim janë përfshirë hulumtimi i parametrave biologjik, morfologjik, pomologjik, prodhues dhe biokimik. Nga rezultatet e fituara është konstatuar se janë shfaqur ndryshime të konsiderueshme në mes të tretmanëve të testuar. Në rastin konkret përdorimi i mikorizës ka dhënë një ndryshim domethënës si në rendiment ashtu edhe në cilësi të frutave, ku vlen të theksohen tretmanët Myco Apply dhe Nutria bio + Trichowell. Në këtë rast tretmani Myco Apply ka arritur të ketë rendiment më të lartë për ha se tretmani kontroll për 69.70 % (10878 kg/ha në raport me 3295 kg/ha), të ketë numër më të madh të frutave për bimë për 52 % (27 fruta/bimë në raport me 13 fruta/bimë), peshë më të madhe të frutave për 37 % (8.78 g/fryt në raport me 5.52 g/fryt). Kjo tregon se përdorimi i mikorizave i ndihmon bimët në kushte të njëjta arrijnë përvetësimin më të mirë të ujit dhe materieve ushqyese nga toka e si rezultat edhe përmirësimin domethënës të rezultateve prodhuese.

Fjalët kyçe: Dredhëza, mikoriza, Albion